



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2023:160371

Datë: 11.12.2023

Numri i dokumentit: 05042204

P.nr.599/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, e përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska, në çështjen penale kundër të pandehurit G. B. me vendbanim në Pejë, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.394/23 të datës 24.07.2023, jashtë seancës, me datë 11.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Kundër të akuzuarit:

G. B. i lindur me datë ....., në fshatin K., Komuna e Pejës ku edhe banon, nga i ati M. dhe nëna N., e vajzërisë D., i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion mesimdhënës, i identifikuar me numër personal ....., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

- Hedhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë, PP.II.nr.394/23 e datës 24.07.2023 dhe Pushon procedura penale për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së, *për shkak se lënda është kryer në procedurën e ndërmjetësimit.*
- Shpenzimet e kësaj procedure bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar aktakuzën, PP.II.nr.394/23 e datës 24.07.2023, kundër të pandehurit G. B., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata me datë 24.11.2023, e ka referuar të njejtën në procedurën e ndërmjetësimi, nga e cila procedurë palët kanë arritur marrëveshjen e datës 01.12.2023.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 të KPPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 229 par.5 dhe nenin 453 par.1 nënpar.4 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.599/23, më datë 11.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij  
Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat  
prej 3 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,  
nëpërmes kësaj Gjykate.